URDHËR
Nr. 300, datë 2.6.2026

PËR DELEGIMIN/AUTORIZIMIN E KOMPETENCAVE TË MINISTRIT TË DREJTËSISË PËR NËNSHKRIMIN E DOKUMENTACIONIT TË KLASIFIKUAR "SEKRET SHTETËROR" TE ZËVENDËSMINISTRI

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të nenit 28 e vijues të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe të ligjit nr. 10/2023, "Për informacionin e klasifikuar",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të ministrit të Drejtësisë për nënshkrimin e korrespondencës dalëse me institucione të ndryshme, kur ato përfshijnë informacion të klasifikuar në nivelin "Sekret" dhe "Konfidencial", te zëvendësministri, znj. Elona Hoxha.
2. Ngarkimin e znj. Elona Hoxha me ndjekjen dhe me zbatimin e këtij urdhri, në përputhje me legjislacionin ne fuqi lidhur me informacionin e klasifikuar.
3. Ngarkimin e Sektorit të Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për ndjekjen dhe njoftimin e urdhrit strukturave përkatëse, që përpunojnë informacionin e klasifikuar ne nivelet e sipërcituara.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Toni Gogu